



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me:	12.07 20 23	
Prilbje:		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
1-035/02-35590		

Zyra e Kryetarit të Komunës

PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E PARË PUBLIKE E THIRRUR NGA KRYETARI I KOMUNËS NË QERSHOR TË VITIT 2023

PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E PARË PUBLIKE E THIRRUR NGA KRYETARI I KOMUNËS NË QERSHOR TË VITIT 2023

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.03/2020 për transparencë në Komuna, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në Komunë, Komuna e Lipjanit harton procesverbal nga mbledhja e parë publike e thirrur nga kryetari i komunës për vitin 2023 i cili është mbajtur me datën 23.06.2023, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 11:00. Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Komuna është e obliguar të mbajdy tubime me publikun, njërin në gjashtëmujorit e parë të vitit fiskal dhe tjetrin në fundvit.

Ecuria e Procesit

Zyrtari përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimit të standarteve minimale të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit ka bërë me kohë lajmërimin dhe ka publikuar njoftimin në ueb faqe të Komunës, në dy gjuhët zyrtare, dy javë para mbajtjes, sipas ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dispoziata e Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit public në Komuna.

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2023/06/20230608145940408.pdf>

Po ashtu njoftimi është vendosur edhe në hyrje të objektit të komunës si dhe në vendet e tjera më të frekuentuara nga ana e qytetarëve.


PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E PARË PUBLIKE E THIRRUR NGA KRYETARI I
KOMUNËS NË QERSHOR TË VITIT 2023

TAKIMI ME QYTETARË



PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E PARË PUBLIKE E THIRRUR NGA KRYETARI I
KOMUNËS NË QERSHOR TË VITIT 2023

TAKIMI ME QYTETARË



Në këtë tubim publik kanë marrë pjesë 61 pjesëmarrës, prej tyre 25 femra dhe 36 meshkuj.

PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E PARË PUBLIKE E THIRRUR NGA KRYETARI I KOMUNËS NË QERSHOR TË VITIT 2023

TAKIMI ME QYTETARË

Takimi i cili është mbajtur **23.06.2023** duke filluar në ora **11:00** në sallën e Kuvendit Komunal ka karakterin informues për pjesëmarrësit, ku përfaqësuesit e komunës njoftojnë për aktivitetet komunale, për të arriturat dhe vështirësitë, për synimet dhe investimet kapitale gjatë periudhës për të cilën është thirrur takimi, ndërsa të pranishmit mund të bëjnë pyetje dhe të japin propozime përfaqësuesve të zgjedhur komunal lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara si dhe për çështje të tjera që janë në interes të qytetarëve.

Për të folur rreth aktiviteteteve të Komunës, për planet dhe sfidat, fjala kryesore i takoj kryetarit të komunës, Imri Ahmeti.

Në prani të drejtorëve të Drejtorateve komunale, përfaqësuesve të Këshillave Lokal përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe shumë qytetarëve tjerë, mbledhjen e hapi kryetari i Komunës, Imri Ahmeti.

Kryetari, Imri Ahmeti pasi ka përshëndetur të pranishmit ka thënë se në këtë takim jemi që të diskutojmë për punën e gjashtëmujorshit të parë vitit 2023, ai po ashtu ka shtuar se kemi arritur që në këtë periudhë që po e lëmë pas të realizojmë me sukses një sërë projektesh duke vazhduar të prezantoj punën e tij por edhe sfidat të cilat e kanë përcjellura në këtë periudhë.

Kryetari Imri Ahmeti është shprehur i kënaqur me dinamikën e investimeve kapitale e cila po shënon një rritje në bazë të planifikimit, ku gjatë këtij viti janë planifikuar 98 projekte kapitale, një pjesë e të cilave është duke u realizuar në teren, ndërsa shumë prej tyre janë në fazat e prokurimit dhe shumë shpejtë do të filloj implementimi i tyre.

Po ashtu, Kryetari Ahmeti, ka vazhduar tutje duke thënë se hyra e përgjithshme vetanake deri në fund të muajit maj ka rritur të realizohet në 67.50%, me theks të veçantë ka përmendur të hyrat e realizuara nga tatimi në pronë që deri më tani është realizuar 55.23% nga planifikimi për vitin 2023 e që është një tregues i mjaftueshëm që deri në fund të vitit do të tejkalohet si qdo here edhe Planifikimi buxhetor në realizimin e tatimit në prone dhe në realizimin e të hyres vetanake në tërësi.

Tutje ai ka theksuar se planifikimi i buxhetit për vitin aktual është realizuar jashtëzakonisht mirë 67.50% Realizimi i planifikimit në tërësi të buxhetit deri më tani është 7,213,389.27 euro ose 33,30% ndërsa investimet kapitale 14.41%

Mallrat dhe shërbimet 38.64%

Subvenconet dhe transferet janë realizuar 24.51%

Shpeizimet komunale 51.38%

PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E PARË PUBLIKE E THIRRUR NGA KRYETARI I KOMUNËS NË QERSHOR TË VITIT 2023

TAKIMI ME QYTETARË

Kryetari Ahmeti ka theksuar se marr në tërësi të gjitha shpenzimet komunale të cilat i potencum. dikanim e realizimit të buxhetit është e kënaqshme në të gjitha segmentet me përjashtim tek investimet kapitale të cilat në 6 mujorshin e parë janë në procedurë të nisjes nga ana e prokurimit të cilat pritet të zhvillohen deri në fund të qershorit përveç që disa projekte të cilat do ti shikojmë me rishikim dhe pritet që të shkojnë në procedura më vonë projekte këto të cilat pritet me u zhvillu deri në fund të vitit.

Me këtë trend unë jom i bindur që do të dalim mirë dhe do jemi ndër komunat më të mira sa i përket realizimit të buxhetit si në realizimin e planifikimit dhe në realizimin e të hyrave, ndërkaq na mbetin edhe punë të tjera rreth infrastrukturës në teren të cilat janë në zhvillim e sipër, po ashtu kemi edhe sfida rreth në procedurave për shkak të inflacionit dhe levizjes së qmimeve.

Kryetari Ahmeti, para qytetarëve prezent ka prezantuar punët të cila po bëhen në teren, duke potencuar se janë gjithsejt 98 projekte të cilat disa nga to janë financim nga Granti i Përformancës që ka fituar Komuna e Lipjanit e disa nga të hyrat vetanake dhe disa projekte janë të bartura nga viti i kaluar e të cilat kanë qenë disa projekte ku operatorët ekonomik nga rritja e qmimeve në treg kanë ngec në realizimin e punimeve, tani jemi në fazën e procedurës së prokurimit.

Në të njëjtën kohë ai ka ftuar qytetarët që të jenë sa më bashkëpunues sa më aktiv që nëpërmjet sugjerimeve, vërejtjeve dhe kërkesave të bëhen pjesë e pandashme e ndikimit në përmirësimin e jetës së gjithë qytetarëve të Komunës së Lipjanit.

Kryetari Imri Ahmeti po ashtu ka njoftuar të pranishmit se tani jemi në kohën e hartimit të Kornizës Buxhetore e cila gjatë vitit mund edhe të pesojë ndryshime, qoftë nga rishikimi i buxhetit, qoftë nga redistribimi, qoftë edhe nga tejakillimet e të hyrave, qoftë edhe nga donacionet dhe grantet që marrim gjatë vitit, por që kontributi juaj përmes dëgjimeve buxhetore për KAB që po zhvillohen është i jashtëzakonisht i duhur për lokalitetet dhe venbanimet nga ju vini në mënyrë që t'i zgjedhim bashkarisht problemet e ndryshme kolektive por edhe ti realizojmë projektet më prioritare për vendin tuaj.

PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E PARË PUBLIKE E THIRRUR NGA KRYETARI I KOMUNËS NË QERSHOR TË VITIT 2023

TAKIMI ME QYTETARË

Unë këtu po e përmbylli prezantimin tim duke ju falenderuar juve për prezencën e juaj dhe për të ju dhënë juve mundësinë për të ngritur ju tema e çështje për të cilat keni interesim.

Kontributi juaj është i jashtëzakonisht i duhur për lokalitetet dhe venbanimet që ju vini në mënyrë që t'i zgjedhim bashkarisht problemet e ndryshme kolektive.

Ndërsa qytetarët u inkuadruan për të bërë pyetje dhe për të kërkuar sqarime nga Kryetari Imri Ahmeti për shumë çështje.

Zymer Ahmeti – përfaqësues i lagjes së Akllapit në Lipjan, me siguri jeni në ngjarje për infrastrukturen në lagjen e Akllapit dhe ka pyetur a ka ndonjë plan apo projekt komuna për rregullimin e infrastruktures rrugore dhe ndriqimin publik të cilat janë të domosdoshme për qytetarët e kësaj lagje.

Kryetari Imri Ahmeti: Në Lagjen e Akllapit tani më janë në procedura të prokurimit për asfaltim disa rrugë, ndërsa për rrugët e tjera ne kemi kërkuar nga banoret e lagjes së Akllapit që të marrin pelqimin me shkrim nga pronari përmes noterit dhe ne ju sigurojmë se do të ju asfaltojmë rrugët e mbetura. Unë kërkoj nga qytetarët e Lipjanit këtë fenomen me stopu, është problematike me hyrë në në pagesa të rrugëve për interesa private.

Rruga kryesore rreth lumit është asfaltuar, tani ka mbetur vetëm një shtresë e cila edhe ajo së shpejti do të bëhet, e po ashtu do të kompletohet edhe me ndriqim e trotuarë, që do të thotë ishin ndërtuar të gjitha edhe me tutje po të ishin pronë publike.

Po ashtu ju informoj se edhe KEDS përmes një shkrese na ka informuar se ku do të bëjë investime në Komunën e Lipjanit e që është e planifikuar edhe lagjeja e Akllapit me investime.

Rinor Reqica- përfaqësues nga fshati Rubovc i Vogël, ka pyetur për rregullimin e kanalizimit për 11 shtëpi që jetojnë në këtë vendbanim dhe që e kanë shumë të nevojshme, trotuarin në drejtim të shkollës si dhe ndërtimin e një fushe të hapur sportive këto kërkesa janë nga qytetarët e fshatit.

PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E PARË PUBLIKE E THIRRUR NGA KRYETARI I KOMUNËS NË QERSHOR TË VITIT 2023

TAKIMI ME QYTETARË

Kryetari Imri Ahmeti: Jam i njoftuar me problemin e këtyre familjeve në Robovc të Vogël ku ka pasur disa probleme gjeografike rreth kyqjes kur është ndërtuar kohë më parë dhe një pjesë e kemi lidhur me lumen aty pranë por shpresoj që edhe pjesa e mbetur ka me përfundu së shpejti, ndërsa për trotuarin kemi me bë përpjekje me fut në projekte buxhetore, ndërsa për fushën e sportit e ka një fushë të shkolla dhe një tjetër afër është në Kojksë e cila për momentin i plotëson nevojat e qytetarëve.

Kamer Podrimqaku- përfaqësues i Lagjes të Xhamia në Lipjan ka ngitur si shqetësim kyqjen e nxënësve për në shkollën “Ismaïl Luma”, pasi që është një lagje bukur e madhe dhe ka një numër të madh të nxënësve të cilët për me shku në shkollë duhet me shku kogja rrotull e mu sjell ka Xhamia, kurse është një mundësi me asfaltu një rrugë afër aty e që e shkurton rrugën deri të shkolla.

Kryetari Imri Ahmeti: Jam i informuar me këtë kërkesë dhe përmes Hartes Zonale ka me fillu gjatë këtij viti shpronësimi i rrugës i cili lidh të gjitha rrugët e lagjes Mostina dhe do të lidhet me Haredin Bajramin dhe besoj që ky projekt do të përfundoj vitin e ardhshëm.

Mustafë Rexhepi - Gadime e Epërme ka pyetur lidhur me kompanitë që kryejnë punimet se a kanë ndonjë afat kur i kryejnë punimet si për shembull në Gadime të Epërme ndërtimi i shtratit të lumit ka ende punë si ndërtimi i murit mbrojtës e punë të tjera, ai po ashtu ka paraqitur si shqetësim lidhur me kamionat e mëdhenjë me peshë të rëndë të cilët po e shkatërrojnë rrugën që vie nga Llugaxhia –Gadime –Gjilan.

Kryetari Imri Ahmeti: Të gjitha projektet kanë afat për kryerjen e punimeve por për shkak të inflacionit që ka ndodh qeveria ka nxjerr udhëzim administrativ me i subvencionuar kompanitë dhe ky afat është pezulluar për një periudhë kohore. Por për ne nuk është problem çështja e kohës është çështja e cilësisë së punimeve ku gjatë ndërtimit të lumit në Gadime na janë kërkuar edhe nevoja tjera teknike në hapje të lumit për shkak të mbeturinave. Ne jemi munduar të kontribuojmë si komunë me nga një shportë për mbeturina për qdo familje në mënyrë të mos hedhjes së tyre në lumenjë por na duhet ende si shoqëri vedijesimi.

Elmi Krasniqi- Qytetarë nga Lagjja e Akllapit kërkon të dijë sa projekte janë planifikuar për lagjen e Akllapit, konkretisht të rruga “Sadik Shala”, ndriqimi është stërvjetruar ku duhet të ndërrohet dhe të kompletohet me trotuarë, po ashtu për arsye sigurie kërkojmë që të ketë edhe pengessa në rrugë për ndalim të shpejtësisë.

PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E PARË PUBLIKE E THIRRUR NGA KRYETARI I KOMUNËS NË QERSHOR TË VITIT 2023

TAKIMI ME QYTETARË

Kryetari Imri Ahmeti: Gjatë këtij viti është planifikuar të asfaltohen dy rrugë që lidhin rrugën transit- Janjeve Lipjan që hyn në qytet e që lidhet me rrugën Sadik Shala te termoventi, po ashtu edhe ndriqimi është në projekt për rikonstruim i cili do të bëhet me ndriqim të ri, ne e kemi pasur edhe një projekt për asfaltimin e rrugës atje në fund afër rrugës Sadik Shala por kemi pasur nga një palë një pengesë, ne do të bëjmë edhe rikonsruimin e ndriqimit publik në rrugën Ganimete Tërbeshi rruga e vjetër e për në Konjuh ndriqim i ri komplet përgjatë rrugës. Pengesat në rrugë edhe pse ajo rrugë ka disa pengesa por që sjanë të mjaftueshme por besoni qe edhe ato pengesa që janë ka kërkesa nga banorët e lagjes mu largu ato, si problem të tillë po kemi në shumë lokalitete ku njëherë po kërkohet me u vendos pengesat pastaj mi tërheq. Ne jemi duke u munduar që përmes një komisioni me i evidentu kërkesat e qytetarëve dhe me pa se ku ka nevojë ose rrezikshmëri nga kalimi fëmijëve në mënyrë që të vendosim zebra në formë pjerrine e që është më e butë e jo pengesa të nalta

Naim Reçica - Përfaqësues nga fshati Gllavicë, ka paraqitur disa kërkesa, rreth 2 km rrugë të cilat duhet të asfaltohen rrugë të lagjeve (sekondare) dhe një pjesë diku rreth 500 metra trotuarë me ndriqim publik të cilat janë të domosdoshme për nxënësit që kalojnë deri te shkolla.

Kryetari Imri Ahmeti: Jam në dijuni që ka nevojë për asfaltim të rrugicave e di që ka nevojë për shtim të ndriqimit publik por ne e kemi ndërtuar rrugën kryesore së bashku me trotuarin dhe ndriqimin, rrugë kjo në të cilën kalojnë fëmijët për të shkuar në shkollë, por ne do të shikojmë mundësitë për ti futur në projekte edhe ato pak rrigica që kanë mbetur dhe kërkesat e tjera që vijnë nga banorët e Gllavicës

Gëzim Bytyqi- Përfaqësues nga fshati Qylagë ka falenderuar për punën dhe angazhimin e komunës në drejtim të përmirësimit të kushteve të jetës dhe ka pyetur se a do të vazhdoj rregullimi i ujësjellsit pasi që është nevojë elementare për Qylagen. Aka të interesuar për të vendosur bizneset në Zonën Ekonomike në Kërqevë pasi që është në përfundim e sipër kjo zonë, si dhe kërkesa tretë është rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Qylagë e posaqërisht te shkolla.

Kryetari Imri Ahmeti: Ujësjellsi është i rregulluar dhe ka përfunduar në Qylagë por pse sështë funksional duhet me kontaktuar kompaninë e Ujësjellsit dhe banorët e Qylagës, ju e dini se banorët nuk e kanë dashtë ujësjellsin që nga fillimi i instalimit nëse ka gaditshmëri atëherë edhe në disa lokalitete ku kemi probleme të tilla do të përpiqemi me Kompaninë e Ujësjellsit me lëshu edhe pse duhet mirëmbajtje dhe të hyni në obligime ndaj ujësjellsit.

PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E PARË PUBLIKE E THIRRUR NGA KRYETARI I KOMUNËS NË QERSHOR TË VITIT 2023

TAKIMI ME QYTETARË

Zona Ekonomike problem për momentin është vetëm me rrymen KEDS deri sa të rregullon tensionin e lartë për ndërmarrjet që do të punojnë atje. Në këtë zonë katër operatorë kanë marrë tani më prona atje që do të fillojnë së shpejti me punën e ne në vijim të angazhimeve tona do të ftojme edhe investitorë tjerë në këtë zonë. Unë jam shumë i interesuar ta funksionalizoj këtë zonë me fillu punën sepse është shumë në interes të komunës për me pas një zonë të tillë në menyrë që çdo investitor i interesuar për investime me pas një hapësirë ku me u drejtu.

Do të përpiqemi që në agjendën tonë buxhetore ta fusim edhe ndërtimin e shtratit të lumit për fshatin Qylagë në mënyrë të krijojmë edhe këtu një ambient më të mirë.

Gjyla Kërpuzi- Kryetare e fshatit Shalë tha se është e nderuar që i'u është besuar udhëheqja si kryetare e këshillit të fshatit, me kërkesën që në të ardhmen të ketë më shumë gra si përfaqësuese të vendbanimeve qofshin ato fshatra apo lagje, ajo ka paraqitur disa kërkesa nga qytetarët e Shalës si rregullimin e ujësjellsit, kanalizimit dhe pusëve disa trotuare, po ashtu kemi memorialin e UÇK-së dhe një Qender Rinore për fshatin.

Kryetari Imri Ahmeti: Në fshatin Shalë rrugët kryesore janë shtruar edhe janë ndërtuar trotuarët me ndriqim publik, janë shtruar edhe shumë rrugica tjera, po ashtu në Shalë janë dy Qendra Rinore por do shohim sa është e nevojshme, por kemi me bërë përpjekje për t'i futur në buxhet edhe kërkesat e tjera që dalin nga qytetarët, kërkesën për memorialin tani më kemi biseduar me fshatin dhe do da mbështesmi këtë projekt.

Ajet Shala – Nga Jeta e Re, ka kërkuar ndriqim, mirëmbajtje të mbeturinave, pjesëmarrje të pjesëtarëve të policisë gjatë ceremonive në varreza si dhe rrugë më të zgjeruara afër varrezave.

Kryetari Imri Ahmeti: Jeta Re rrugën kryesore e ka të asfaltuar e të kompletuar me trotuarë e ndriqim janë edhe disa rrugica të vogla por edhe ato në vazhdimësi të angazhimeve tona do ti përfundojmë, qështja e varrezave ne jemi duke e realizuar agjendën tonë në mirëmbajtjen e varrezave, ndërsa për prezencën e pjesëtarëve të policisë në ceremonitë e varrimit është kërkesë që don interpretim edhe nga vet policia e Kosovës, parkingjet e varrezave janë vërtet një problem sepse spo ka hapësira të mjaftueshme ne jemi duke e ndërtuar një ide një projekt të përbashkët që për vitet e ardhshme me pas investime në të gjitha varrezat se si i kemi rregulluar në qytetin e Lipjanit jemi duke bërë përpjekje që përmes donacioneve ta rregullojmë infrastrukturen në gjitha varrezat në komunën e Lipjanit që i bjen aty ku ska rrethoja ti vendosim aty ku mujna me punu me vazhdu me punu aty ku ka vend për parkingje me i rregullu ato, por si ide i kemi dy projekte i cili është për zhavorim të rrugëve sepse e shoh shumë të nevojshme.

PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E PARË PUBLIKE E THIRRUR NGA KRYETARI I
KOMUNËS NË QERSHOR TË VITIT 2023

TAKIMI ME QYTETARË

Xhevat Zeqiri- Lipjan ka kërkuar që të bëhet një zgjidhje për zhurmën e cila po krijohet në qytet konkretisht në Sheshin Adem Jashari, e sidomos në sezonin e verës, si dhe një shqetësim tjetër është kompania kontraktuar e cila është duke e pastruar sheshin e qytetit të jetë më e përgjegjshme sepse para një viti çdo jav është pastruar sheshi e tash nuk po ndodh ashtu.

Kryetari Imri Ahmeti: Ka thënë se jemi në dijeni lidhur me këtë shqetësim sa i përket zhurmës në qytet e posaqërisht në shesh, ne se bashku me inspektoriatin dhe policinë do ta shikojmë se qka do mujna me ndërmarrë në këtë drejtim.


Hasim Salihu: Nga fshati Banullë ka përgëzuar qeverisjen lokale për punën dhe angazhimin, ndërsa ka paraqitur shqetësimin e tij dhe të fshatit lidhur me kompaninë për mirëmbajtjen e lumenjëve, ku thotë se jemi të kënaqur sepse nga të reshurat e shpeshta këtë vit kemi pasur probleme me ujin e sidomos tek një urë e vogël kur shumë herë ka kalu uji mbi këtë urë edhe si pasojë e mbeturinave.

Kryetari Imri Ahmeti: Kontrata për mirëmbajtje të lumenjëve dhe hapësirave nëpër disa fshatra e në këtë rast edhe Banullës ka skaduar për momentin nuk kemi kontratë lidhur me ndonjë kompani, ne tani jemi në procedurë për zgjedhjen e ndonjë operatori ku shpresoj që shumë shpejtë do të ndërmerren masat në pastrimin dhe mirëmbajtje.

Takimi ka përfundur në ora 12:50

Bukurie Zejnullahu -Jashari

Udhëheqëse e Sektorit për Komunikim me Publikun



Lipjan, 10.07.2023